



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë: 21.7.2023

Nr: 717

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË PUKË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALDEMOKRATE", ZJ. AIDA ALUSH CENAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1251 prot., datë 18.7.2023, Këshilli i Bashkisë Pukë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Drita Frrok Gjoka, i propozuar nga subjekti politik "Partia Socialdemokrate".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate" për Këshillin e Bashkisë Pukë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 6, zj. Aida Alush Cenaj.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Datë: 21.7.2023 Nr: 717  
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate", zj. Aida Alush Cenaj".

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit “Partia Socialdemokrate”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 23527 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Aida Alush Cenaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Aida Alush Cenaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Aida Alush Cenaj, në Këshillin e Bashkisë Pukë, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Aida Alush Cenaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Aida Alush Cenaj, në Këshillin e Bashkisë Pukë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, zj. Aida Alush Cenaj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**